



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 21 maj – 08 qershor 2018.
2. Miratimi i kalendarit dhe plani i masave/aktiviteteve në zbatim të plan veprimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të raportit të vitit 2016 të Komisionit European për Shqipërinë maj – korrik 2018.
3. Fillimi i shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Tom Doshi, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Bledar Çuçi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Të ftuar:

Adrian Shega - Drejtori i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Periand Teta – përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë

Maksim Haxhia - Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Rezarta Abdiu - Drejtore e Trajnimit Vazhdues të Avokateve në Dhomën Kombëtare të Avokatisë

Agnes Bernhard - shefe e misionit EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje të gjithëve!

Meqenëse kuorumi është formuar, vazhdojmë me rendin e ditës!

Sot Komisioni i Ligjeve ka në rend të ditës tri çështje.

Çështja e parë është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 21 maj – 8 qershor 2018, të cilin kolegët e kanë mbi tavolinë. Kalendarit është në përputhje me programin dhe kalendarin e miratuar në Kuvend.

A ka kush gjë për kalendarin?

Po, zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri – Zoti kryetar, kalendarit nuk përmban çështjen më të rëndësishme të 27 vjetëve të fundit. Ka 10 ditë që kjo qeveri është kapur në flagrancë duke flirtuar me krimin, ku është zbërthyer i gjithë mekanizmi dhe si zhvillohet narkotrafiku, veçanërisht këta 5 vjetët e fundit në këtë vend. Kjo shpjegon me detaje edhe faktin se pse Shqipëria në 5 vjetët e fundit u ngjiti në majat më të larta të çdo liste të zezë që klasifikon krimin e organizuar, drogën, prostitucionin dhe çdo të pabërë që mund të bëjë krimin i organizuar në një territor nën mbikëqyrjen e qeverisë. Ka 10 ditë që kanë dalë fakte dhe prova autentike dhe besoj nuk keni ndonjë dyshim tani, apo po prisni përgjigjen e Kryeministrit?!

Ulsi Manja – Jo, për kalendarin po presim, vetëm shkurt të lutem!

Gent Strazimiri – Për atë po flas dhe unë dhe do të flas aq sa të kem fjalë për të thënë. Ti mos më ndërprit, mbaje mikrofonin mbyllur dhe të më dëgjosh deri në fund! Po të shpjegoj faktin se si ne jemi të drejtuar në këtë vend nga një narko-qeveri, së cilës dita ditës po i bëhet një koperturë një narko-parlament dhe unë nuk do të doja që Komisioni i Ligjeve të kthehet në një narko-komision, pra të kthehet në një avokat të një narko-qeverie, e cila është kapur me presh në duar tashmë në mënyrë të vazhdueshme. Po gjithsesi, kjo e fundit fare është krejtësisht e pakalueshme. Të shqyrtojmë faktin se si na ndodhi që ministrat e Brendshëm të këtij vendi për 5 vjet resht kanë qenë persona me lidhje direkt të provuar jo të dyshuara, me markotrafikun. Nuk është më një deduksion logjik, por kemi prova dhe fakte, të cilat janë aq të forta sa që sot, drejtori i Përgjithshëm i Policisë, i emëruar nga Agron Xhafaj

(ndërprerje, pa mikrofon)

Do të ngrenë hetime të gjejnë a është vallë i dyshuar Agroni dhe Fatmiri për këtë që kanë bërë, për të cilët tashmë ka dalë në prova autentike. Unë mendoj se sot ne duhet të merremi me këtë punë derisa t'i dalë koka kësaj pune dhe të mos kthehemi në një koperturë të narko-trafikut, të narko-qeverisë dhe narko-policisë. Me këto letra në duar ka 5 vjet që na thotë, kryenarkotrafikanti në qeveri, ai që mbron dhe rekruton Agronët, Fatmirët, Saimirët, Habilajt,

dhe, për shkak të parave të ndyra, prej të cilave fiton zgjedhjet, ka 5 vjet që na thotë me letra: “Jam në rregull, jemi shumë mirë, jemi më mirë se 10 vjet më parë, kemi më pak kanabis se 10 vjet më parë, kemi më pak trafik se 10 vjet më parë”. Çdo njeri që e shan, flet shqip. Domethënë, Departamenti i Shtetit, CIA, Zyra e UN-it për drogat, gjithkush flet shqip. Të gjithë i ka rekrutuar dhe i ka blerë Lulzim Basha, vetëm ky është në rregull. Ndërkohë, paturpësisht, 4-5 orë pasi kishte dalë videoja (mos i tund letrat, sepse kjo punë nuk është çështje letrash), del dhe thotë nga Parisi: “E çova në një laborator shumë të specializuar dhe laboratori më prestigjioz tha se nuk ekziston kjo gjë”.

Ulsi Manja – Zoti Strazimiri, ju lutem, për kalendarin...

Gent Strazimiri – Rendi i ditës, kalendar 2-javor, 3-javor, 2-ditor, 3-ditor, nuk mund të ketë çështje tjetër përveç kësaj në këtë vend. Sot këtu do të ndajmë dhe duhet ta ndajmë. Është çështje faqeje për secilin prej nesh. Secili nga ne sot këtu duhet ta ndajë, duhet të deklarojë nëse është me narkotrafikun apo është me shtetin, është me narkotrafikun apo është me ligjin, është me kazmë në dorë për të shkatërruar çdo gjë të mirë, gjysma-gjysma, siç i kemi bërë në këta 27 vjet, apo secili ka marrë një mistri të vogël, një shpatull të vogël për të hedhur një dorë llaç dhe për të vënë një gur në murin e shtetit demokratik dhe shtetit të së drejtës në këtë vend.

Ulsi Manja - Dakord.

Gent Strazimiri – Komisioni i Ligjeve nuk mund të bëjë dot sikur nuk ka ndodhur gjë. Komisioni i Ligjeve, që, për fat të Zotit, nuk është i përbërë vetëm nga ju, nuk mund të presë përgjigjen e laboratorit prestigjioz të Edi Ramës. Me sa duket, është laborator nga këta që bëhet drogë në Libofshë, në Xibrakë, e kushedi se ku tjetër, që merret edhe me audiopërgjimet, që të gjejë nëse është apo nuk është zëri i Agronit.

Sot keni një javë, për turp të Zotit, qofshi ju që jeni, që i thoni miletit: “Kjo është e sajuar. Ky nuk është zëri tij”, madje garantoheni me laboratorë prestigjiozë.

Ulsi Manja – Flisni për kalendarin, zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri – Sot nuk keni më asnjë arsye të logjikshme.

Ulsi Manja – Ju lutem, për kalendarin!

Gent Strazimiri – Nuk keni asnjë mundësi të logjikshme për të mbrojtur ...

Ulsi Manja – Për kalendarin.

Gent Strazimiri – Ju bëj thirrje...

Ulsi Manja – Kush është ...

Gent Strazimiri – Kalendarin dhe rendi i ditës sot e në vazhdim është vetëm çështja: si të shpëtojmë vendin nga narkotrafiku, nga narkoqeveria.

Ulsi Manja – Kush është dakord me kalendarin?

Gent Strazimiri – Si të ndalojë faktin që parlamenti është ...

Ulsi Manja – Kush është dakord me kalendarin e komisionit për periudhën 21 maj ...

Gent Strazimiri – Nuk mund ta hedhësh në votim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – 10 vota pro.

Oerd Bylykbashi – Zoti Manja, ke shkelur Rregulloren e Kuvendit.

Ulsi Manja – Kush është kundër?

Oerd Bylykbashi – Zoti Manja, ke shkelur Rregulloren e Kuvendit. I ke mohuar fjalën iniciatorit të këtij ligji.

Ulsi Manja – Miratohet kalendari i punimeve të komisionit për periudhën 21 maj-8 qershor 2018.

Oerd Bylykbashi – Dakord.

Ka mundësi të flas për procedurë?

Ulsi Manja – Të vazhdoj unë me rendin e ditës. Më pas merreni fjalën për procedurë.

Oerd Bylykbashi – Jo, për procedurë.

Ulsi Manja – Pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit dhe plani i masave...

Oerd Bylykbashi – Për procedurë.

Ulsi Manja – Do të ta jap unë fjalën.

Miratimi i kalendarit dhe plani i masave...

Oerd Bylykbashi – Nuk ka Rregullore rurale, quhet Rregullore e Parlamentit.

Ulsi Manja - ... aktiviteteve në zbatim të planveprimit të Kuvendit të Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të raportit të vitit 2016 të Komisionit Europian ...

Oerd Bylykbashi – Ulsi, ti, me rregulloren tënde, si rregullore kooperative, ne vazhdojmë me ...

Ulsi Manja - ... për Shqipërinë maj-korrik 2018.

Oerd Bylykbashi – Më jep fjalën për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Kush është dakord me miratimin e kalendarit?

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Ka mundësi?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Pro? 10. Kundër?

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Ka mundësi të më jepni fjalën për procedurë?

(Diskutime pa mikrofon.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Fillimi i shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” (*Komision përgjegjës.*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Tom Doshi, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Bledar Çuçi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Të ftuar:

Adrian Shega - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Periand Teta – përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë

Maksim Haxhia - Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Rezarta Abdiu – Drejtoreshë e Trajnimit Vazhdues të Avokatëve në Dhomën Kombëtare të Avokatisë

Agnes Bernhard - shefe e misionit EURALIUS

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Lëre pikën e tretë, pikën e katërt. Më jep fjalën për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja - Karagjozin shkoni e bëjeni në ndonjë komision tjetër, jo tek unë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Je duke shkelur procedurën. Je duke shkelur Rregulloren.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja - Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Komisioni ynë është komision përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji. Relator është kolegu Adnor Shameti.

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Më jep fjalën për procedurë!

Ulsi Manja – Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë zoti Ardian Shega, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Oerd Bylykbashi – Zoti Manja, që nuk merr vesh ...

Ulsi Manja – Zoti Periand Teta.

(Diskutime pa mikrofon.)

Kryetari i Dhomës së Avokatisë, zoti Maks Haxhia.

Oerd Bylykbashi – Më jep fjalën për procedurë.

Ulsi Manja – Patjetër që do ta jap.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zonja Rezarta Abdiu, drejtoreshë e Trajnimit Vazhdues të Avokatëve në Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nga misioni EURALIUS kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Agnes Bernhard, shefe e misionit.

Kjo është pika e tretë e rendit të ditës dhe është një projektligj shumë i rëndësishëm.

Oerd Bylykbashi - Zoti Manja, në qoftë se do të vazhdoni mbledhjen, ma jepni fjalën për procedurë!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Para se të fillojmë me shqyrtimin dhe diskutimin nen për nen, për procedurë e ka kërkuar fjalën zoti Bylykbashi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani është radha për procedurë.

Oerd Bylykbashi - Zoti Manja, unë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Të lutem, sepse jeni mysafirë në këtë komision, te komisioni juaj shkoni dhe bëni çfarë të doni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Nuk ka mysafirë, por janë deputetë të parlamentit të Shqipërisë dhe me procedurë me Rregullore kanë të drejtë të jenë pjesë e mbledhjes së komisionit.

Ulsi Manja – Të lutem, vazhdoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me qetësi!

Unë jam njohës i mirë i historisë 27-vjeçare të parlamentarizmit dhe e di shumë mirë se çfarë ka pasur ky parlament.

Oerd Bylykbashi – Po, edhe asaj pjesës së komunizmit.

Ulsi Manja – Fjala për ju zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti Manja, sot është 45-vjetori i revoltës së Spaçit, dakord!

Pra, është 45-vjetori i revoltës së Spaçit, kur ata burra atje u ngritën kundër regjimit, që sot e kësaj dite ti je ende përfaqësues i atij regjimi.

Në atë kohë hetuesi i Ministrisë së Brendshme, Fatmir Xhafaj, i cili ka pasur një kontribut thelbësor në mbushjen e atyre burgjeve, ka bërë rrugë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund edhe të udhëtosh jashtë shtetit.

Më falni, të mbaroj unë njëherë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai ka bërë karrierë dhe sot është ministër i Brendshëm, i cili është bërë avokati, meqenëse e keni temën për avokatinë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Zonja Ferhati, të lutem!

Oerd Bylykbashi – Fatmir Xhafaj sot është avokati më i mirë i krimit të organizuar. Ministri i Brendshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem, a do ta dëgjoni zotin Bylykbashi, apo jo?

Oerd Bylykbashi – Meqenëse jemi në temë, sot ministri i Brendshëm është avokati më i mirë i krimit të organizuar. Është ai, i cili ka mbrojtur vëllanë e tij kriminel, të dënuar me

të gjitha format. Për ta mbrojtur, në mënyrën më të mirë të mundshme, e paktoi dhe e dërgoi në Itali, ndërkohë që duhet të fillonte që sot ndjekja penale për të për trafik të lëndëve narkotike. Sigurisht, do të ketë edhe elemente të tjera që do të dalin, por ne sot jemi para faktit që avokatia më e mirë që po i bëhet krimit, është ajo që po i bën Edi Rama, i cili po mbron Saimir Tahirin, i përfshirë në krimin e organizuar dhe po mbron Fatmir Xhafajn, protektorin kryesor të krimit sot.

Pra, është e kotë që në këtë komision të flasim për ligje avokatie kur avokatinë e krimit e bëni ju. Është turpi i deputetëve të maxhorancës, që sot vazhdojnë dhe mbrojnë Fatmir Xhafajn, i cili duhet është i shkarkuar në këtë moment për të gjithë aktivitetin e tij kriminal.

Ulsi Manja – Kjo është puna jonë, se për këtë i kemi marrë votat.

Oerd Bylykbashi - Kriminal në mbështetje dhe në mbrojtje të kriminelëve.

Sigurisht që votat i ke marrë edhe me paratë e drogës, por ju sot ky komision nuk mund të vazhdojë më tej për sa kohë nuk është shkarkuar Fatmir Xhafaj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ne nuk kemi ardhur që të bëjmë galletë me ju këtu!

Oerd Bylykbashi – Qëllimi i Komisionit të Ligjeve nuk është që të mbrojë kriminelët.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja ti bëhesh palë me avokatët e krimit, për rrjedhojë ky komision nuk mund të vazhdojë të diskutojë çështje të tjera, për sa kohë Fatmir Xhafaj, ministri i Brendshëm, mbron krimin sot e kësaj dite, në krye të qeverisë, bashkë me atë që i ka dhënë prokurën.

Ulsi Manja – Si e kishte ai, “Babalja”?!

Pra, bashkë me të!

Oerd Bylykbashi – Ai me Xhafajn, të dy bashkë, janë përfshirë kokë e këmbë, njëri si ministër dhe tjetri si trafikant.

Ulsi Manja – A mund ta përmbyllni, ju lutem!

Oerd Bylykbashi - Ti bëhesh palë me ta, bashkë me kolegët e tu, ndaj ky komision nuk mund të mbrojë kriminelët.

Ulsi Manja – Ti po më kërkon mua që të mos kryej detyrën!

(Diskutime pa mikrofon.)

Klevis Balliu - Zoti Kryetar, kërkoj fjalën për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Zoti Haxhia, si dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, do t’ju lutem që të jeni korrektë, sepse do të kalojmë në diskutimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit.

Ju lutem, duhet të flisni me mikrofonin e ndezur!

Oerd Bylykbashi – Jepuni fjalën deputetëve.

Klevis Balliu - Nuk ka për ta marrë fjalën asnjë tjetër, pa e marrë si fillim opozita.

Ulsi Manja – Për nene të caktuara, do t'i lexojmë, siç jemi dakordësuar paraprakisht.

Klevis Balliu - Kërkoj fjalën për procedurë.

Ulsi Manja – Përpara keni një draft të integruar dhe është varianti fillestar i projektligjit, si dhe një tekst integral të dakordësuar midis relatorit, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe misionit EURALIUS.

(Diskutime pa mikrofon.)

Klevis Balliu - Më jepni fjalën për procedurë.

Oerd Bylykbashi – Jepuni fjalën deputetëve.

Ulsi Manja – Për procedurë kemi mbaruar. Zoti Strazimiri dhe zoti Bylykbashi folën për procedurë.

Oerd Bylykbashi – Çdo deputet i parlamentit ka të drejtë të marrë fjalën për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem, mos më pengoni që të bëj detyrën!

(Diskutime pa mikrofon.)

Klevis Balliu - A ka mundësi ta marr fjalën?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja - Zoti Shamenti, vazhdoni me projektligjin “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.”

Vazhdojmë me nenin 1.

(Diskutime pa mikrofon)

Klevis Balliu – Nuk ka për të funksionuar ai inskenim që keni përgatitur për të dhënë idenë se këtu është një situatë normale e punimeve të Kuvendit. Nuk do të arrini të mbroni çdo ministër të Brendshëm të lidhur me drogën.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi, dëgjoje!

Më shumë përgjegjësi keni ju, që mbroni këta, se ata vetë.

(Diskutime pa mikrofon)

I keni bërë punimet e parlamentit dhe punimet tuaja në Kryesinë Kuvendit, punime palaço. Jeni bërë palaço nga i pari tek i fundit!

Nuk vini dot me një argument për të hedhur poshtë një akuzë të opozitës.

Deri dje mbronit Saimir Tahirin, sot e keni në arrest shtëpie.

Thoni se këto përgjimet nuk janë të vërteta. Pse iku i vëllai në Itali, kur nuk janë të vërteta përgjimet? Jepni përgjigje për këtë! Apo edhe ne jemi të gjithë si ajo gazetarja? “Opozita mashtron”, ndërkohë të gjithë mafiozët janë te partia juaj.

Ideja e inskenimit që keni krijuar këtu sot, që të jepni idenë se këtu po vazhdojnë punimet me normalitet, ndërkohë që të gjithë qytetarët shqiptarë... Njërin e vrotë në burg me këtë policinë e inkriminuar. Mbase i droguat shqiptarët, sot po i vrisni.

Në qoftë se doni ta vazhdoni këtë lojë që flisni e flisni duke lexuar, mua më duket nivel shumë i ulët.

Ulsi Manja – Zoti Haxhia, zoti Shega, zonja Bernhard, ju lutem, të jemi racionalë! Do të na ndiqni nën për nën. Tekstin integral e keni përpara.

(Deputeti Klevis Balliu flet pa mikrofon)

Vazhdojmë me nenin 1.

Ka ndonjë vërejtje për nenin 1?

Ju lutem, ndizeni mikrofonin!

Klevis Balliu – Ku e keni vetingun në polici sot?

Zoti Manja, ku e ke vetingun në polici sot, se je marrë edhe me veting, edhe me reformë në drejtësi? Ku e ke vetingun dhe gjykatësit?

(Diskutime pa mikrofon)

Të dëgjohemi ne, pastaj të flisni ju dhe të bëni lojërat tuaja politike...!

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk ju kanë votuar shqiptarët që të mbronin drogën.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 1?

(Diskutime pa mikrofon)

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 1, sipas variantit integral të dakordësuar paraprakisht mes relatorit, Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare dhe misionit Euralius.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdojmë me nenin 2.

Relatori?

Adnor Shameti – Dakord me variantin integral të paraqitur.

Bardh Spahia – Është e turpshme që Komisioni i Ligjeve, që duhet të ishte themeli i ligjshmërisë dhe i luftës kundër krimit, sot bëhet palë me krimin duke dalë haptazi në mbrojtje të tij.

Ulsi, të takon të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 2?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Kush është kundër të ngrejë dorën!

Neni 3.

Bardh Spahia – Pyetja që ka sot çdo shqiptar, është: si ka mundësi që ish-ministri i Brendshëm është sot në arrest shtëpie për drogë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adnor Shameti – Nuk ka ndryshime. Jemi me variantin e paraqitur.

Ulsi Manja – Jemi dakord me nenin 3, sipas variantit integral?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Bardh Spahia – Si ka mundësi që ju nuk i jepni përgjigje një pyetjeje të thjeshtë që kanë shqiptarët? Pse nuk e gjeni dot një njeri të pastër pa lidhje me drogën?

Ulsi Manja – Neni 4, “Shërbimi i avokatisë”.

Relatori?

Adnor Shameti – Dakord me variantin e paraqitur.

(Diskutime pa mikrofon)

Bardh Spahia – Ulsi, jepini përgjigje pyetjes të të gjithë shqiptarëve!

Të gjithë presin një përgjigje të vetme: pse nuk e luftoni trafikun e drogës?

Ulsi Manja – Fjalët dhe debatet mbeten, ligji duhet parë me kujdes.

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...detyrimin ligjor dhe të tregohemi të vëmendshëm në shqyrtimin e këtij projektligji shumë të rëndësishëm nen për nen.

Do t’ju lutesha për vëmendje dhe qetësi!

(Diskutime pa mikrofon)

Bardh Spahia – ...Komisioni i Ligjeve duhet të ishte në rresht të parë për luftën kundër drogës dhe krimit të organizuar. Këta sot janë mburoja më e madhe e trafikantëve dhe të trafikut të drogës

Ulsi Manja – Neni 4.

Ju lutem!

Nuk është komisioni i “Babales” ky! Ky është Komisioni i Ligjeve i Kuvendit të Shqipërisë.

Duhet të tregohemi të vëmendshëm dhe të duruar, sepse është një projektligj shumë i rëndësishëm, nga i cili do të përfitojë jo opozita, jo deputetët e saj, por do të përfitojnë qytetarët shqiptarë.

Ju lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Përgjigjja më e mirë që ne i japim kësaj zhurme, është të vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.”

Ora e gallatës mbaroi! Ora e “Babales” mbaroi tani! Mediet i kanë të lira. Selinë e kanë gati atje për të filluar me pjesën e tretë të filmit, prandaj do të kërkoja vëmendjen tuaj, të nderuar kolegë, të vazhdojmë me projektligjin.

Neni 4, e kemi lënë, zoti Hyseni, ju lutem, prisni pak sa të mbarojmë nenin 4.

A jeni dakord me nenin 4?

(Diskutime pa mikrofon)

Për neni 3 thamë sipas variantit integral të integruar..

Alket Hyseni – Relatori tha që nuk ka ndryshime.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

A ka ndonjë sugjerim?

Po, fjala për ju.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kam për procedurë, por do të ndalem edhe te neni 4.

Po e nis me procedurën. Ne duhet të vazhdojmë punën, sepse ky është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili në radhë të parë do t’i shërbejë opozitës, sepse bëhet fjalë për profesionin e avokatit dhe opozita do të ketë shumë nevojë për avokat në vijim, pasi në kuadër të reformës në drejtësi shpresojmë që të gjitha strukturat dhe mekanizmat shtetërorë të funksionojnë, sepse deri më sot nuk kanë funksionuar dhe opozita shumë shpejt do të gjendet në pozitë kur do të jetë përballë drejtësisë dhe do të japë llogari për shumë gjëra që i ka shkaktuar vendit në të kaluarën, por edhe për këto që po i shkaktën sot, sepse kjo është një strategji e pastër për të penguar integrimin e Shqipërisë. Ne jemi në një fazë të rëndësishme, në një muaj të rëndësishëm, ku strukturat e Bashkimit Europian dhe shtetet anëtare të tij po shqyrtojnë propozimin e komisionit për kalimin e Shqipërisë dhe të Maqedonisë në fazën e avancuar të nënshkrimit të negociatave, fazë, e cila do t’i bënte nder opozitës dhe pozitës, do t’u bënte nder të gjithë shqiptarëve dhe pikërisht ky është qëllimi, pra përdorimi i çdo mekanizmi, sikurse deri më sot, për ta penguar. Duke qenë se nuk po i mjaftojnë mekanizmat e baltosjes, sot përpiqen me bllokim, duke e bllokuar edhe këtë ligj të rëndësishëm në kuadrin e paketës në drejtësi. Ne do ta vazhdojmë, sepse nuk e shohim si alternativë babalizmin. Me babalizëm Shqipëria jo që nuk shkon në Europë, por as në lagjen Çole të dikurshme, ku ishte i famshmi Zani, sepse shokët

e Babales e kanë vendin prapa hekurave dhe nuk e kanë vendin për t'u diskutuar këtu në parlament.

I nderuar kryetar, po vazhdoj me ligjin. Në nenin 4, pika “b”, propozoj që përveç termave “penalë, civilë dhe administrativë” si institute shumë të rëndësishme, të cilat zgjidhen me ligje të veçanta të futet edhe arbitrazhi dhe ndërmjetësimi, përveç termit të ndonjë natyre tjetër që është në rregull...

Ulsi Manja – Është neni 5, më mos gaboj, apo neni 4?

Alket Hyseni – Neni 4 te varianti i integruar besoj. Relatori...

Ulsi Manja – Pika “b”.

Alket Hyseni – Po, pika “b”: “Përfaqësimi në procesin penal, civil, administrativ, arbitrazh, ndërmjetësim ose të ndonjë natyre tjetër”. Pra, propozimi është të futen dy termat “arbitrazh dhe ndërmjetësim”. Nuk e di se çfarë mendimi ka relatori?

Adnor Shameti – Jam dakord.

Ulsi Manja – Po përfaqësuesit e Dhomës?

Maksim Haxhia – Edhe ne dakord jemi.

Ulsi Manja – Përfaqësuesit e komisionit të Euralius-it?

Adnor Shameti – I përket një natyre tjetër, por arbitrazhi është një gjykatë dhe ndërmjetësimi është i rëndësishëm, sepse zgjidh probleme me kosto shumë të madhe për pagën, kështu që...

Ulsi Manja – Po, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard – (*përkthen përkthyesi*) Të jemi pak skeptik në përdorimin e termit të ndërmjetësimit, sepse avokatët, të cilët nuk e kanë licencën e ndërmjetësuesit mund të mos e ofrojnë këtë shërbim.

Ulsi Manja – Po, ju lutem, zoti Hyseni, sqaroheni propozimin.

Alket Hyseni – Për ta sqaruar propozimin ne themi “përfaqësimi i avokatit në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të palës, jo si ndërmjetësues”. Ndërmjetësi është në rolin e arbitrit, në rolin e gjyqtarit, ndërsa ne po themi në rolin e përfaqësuesit të palës, ku palët në ndërmjetësim nuk shkojnë vetë, shpesh shkojnë me përfaqësues. Pra, është e drejta e tyre të shkojnë vetë dhe të përfaqësohen në procesin e ndërmjetësimit ose me avokat. Duke qenë se ndërmjetësimi është një proces, të cilin ne po synojmë ta fusim rëndom, sepse e konsiderojmë të rëndësishëm për kostot, për kohën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, mendoj se duhet të futet dhe të jetë e cituar shprehimisht në ligjin për avokatinë. Sot avokatët janë në procesin e ndërmjetësimit, përfaqësojnë interesat e palëve dhe duke mos e cituar, mendoj se ullet niveli i këtij instituti dhe rëndësinë e tij.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

A është dakord me propozimin relatori?

Adnor Shameti – Dakord, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Përfaqësuesit e Dhomës?

Maksim Haxhia – Dakord.

Ulsi Manja - Përfaqësuesit e ministrisë?

Adrian Shega – Dakord.

Ulsi Manja - A jeni dakord me nenin 4 dhe sugjerimin e bërë nga kolegu Hyseni?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 5.

Zoti Shameti,

meqenëse projektligji ka pësuar ndryshime pothuajse në të gjitha nenet e tij, të cilat do t'i shohim më vonë, për efekt rekordesh do t'ju kërkoja të lexohej titulli i dispozitës dhe të thuhej çdo nen sipas variantit të dakordësuar në mes të ekspertëve, Dhomës, Ministrisë së Drejtësisë dhe misionit EURALIUS.

Vazhdojmë me nenin 5.

Adnor Shameti - Faleminderit zoti kryetar!

Neni 5 ka të bëjë me ushtrimin e paautorizuar të profesionit të avokatit, dhe ne kërkojmë miratimin sipas variantit të integruar të paraqitur dhe të dakordësuar me misionin EURALIUS, Dhomën Kombëtare dhe Ministrinë e Drejtësisë..

Ulsi Manja – Kush është pro nenit 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet nenin 5.

Vazhdojmë me nenin 6. Fusha e veprimtarisë.

Adnor Shameti- Ky nen është varianti I integruar, i dakordësuar me Ministrinë e Drejtësisë, misionin EURALIUS, dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë, sipas variantit që paraqitet.

Kush është pro nenit 6? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet nenin 6.

Maksim Haxhia – Zoti Alket, këtu dhe përpara arbitrazhit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Te neni 6?

Maksim Haxhia – Po, te neni 6 “Përpara çdo gjykate, prokurorie arbitrazhi apo organi publik”, që të shkojë në koherencë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja– “Përpara çdo gjykate, prokurorie apo organi publik”

Maksim Haxhia - “ Arbitrazhi apo organi publik.”

Ulsi Manja – A është dakord relatori me sugjerimin e bërë?

Adnor Shameti- Dakord.

Ulsi Manja – Pra, dakord për t’u rregulluar për efekt të teknikës legislative në të gjithë tekstin e projektligjit. A është dakord përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë? A është dakord përfaqësuesi i misionit EURALIUS? Dakord.

Kush është pro nenit 6? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet nenin 6 me sugjerimin e bërë nga kryetari i dhomës.

Vazhdojmë me nenin 7 “Papajtueshmëria me ushtrimin e profesionit të avokatit”.

Adnor Shameti- Neni 7 është varianti i integruar, i dakordësuar me Ministrinë e Drejtësisë, misionin EURALIUS dhe Dhomën Kombëtare.

Ulsi Manja – A jeni dakord, sipas propozimit të relatorit?

Adrian Shega - Në fund të pikës 1 të shtohet “Shkolla e Magjistraturës”. Meqenëse në dispozitë thuhet: “me përjashtim të mësimdhënies në institucionet e akredituara të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit”, dhe kjo shkollë ka status të veçantë, atëherë të përfshihet.

Adnor Shameti - Unë mendoj se është e panevojshme të bëhet një shtesë e tillë. Pavarësisht se është rregulluar me ligj të veçantë organizimi dhe funksionimi i Shkollës së Magjistraturës, e ka përcaktuar në nivelet e arsimit një gjë të tillë, kështu që e shoh të panevojshme.

Alket Hyseni – Unë kam një dyshim për termin “akreditim”. Nuk duhet ta ngatërrojmë termin “akreditim” me “licencim”. Ka institucione, të cilat mund të jenë të licencuara, por jo të akredituara. Kjo nuk e bën të paligjshme veprimtarinë tyre, e bën të parëndësishme mbase. Pra, akreditimi është një proces, le të themi, i cili i jep rëndësi atij institucioni dhe i jep vlera diplomës, por ka institucione, të cilat mund të jenë të licencuara, por janë në proces akreditimi dhe kanë pedagogë. Në ligjin e ri të arsimit të lartë janë të ndara proceset, është licencimi, pastaj vjen akreditimi, i cili është i domosdoshëm, por janë faza, të cilat nuk e bëjnë të paligjshme veprimtarinë mes licencimit dhe akreditimit. Në SHBA-ve, në një mori prej qindra dhe mijëra universitetesh ka universitete të paakredituara, ose janë në fazë paraprake.

Adnor Shameti - Unë jam i mendimit që të miratojmë variantin e paraqitur në draftin integral për arsye se në ligjin për arsimin e lartë është e specifikuar që nuk njihet diploma. Në ligjin për arsimin e lartë thuhet që para se të dalë diploma e parë institucioni i arsimit të lartë duhet ta ketë kompletuar procesin e akreditimit, njohjen e diplomës. Kjo është gjuha që ka ligji për arsimin e lartë. Pra, para se të japë diplomën e parë, duhet të ketë bërë edhe akreditimin institucional, edhe akreditimin e diplomave.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni- Unë njoh shumë avokatë të nderuar, të cilët sot punojnë si pedagogë të jashtëm pranë Universitetit të Tiranës, i cili është ende i paakredituar, po jua bëj me dije këtë. Po e marr si shembull, sepse është universiteti ikonë dhe më i madhi në vend. Kjo do të thotë që nuk është i njëjtë procesi i akreditimit me procesin e licencimit. Çfarë lidhje ka punësimi i avokatit me vlefshmërinë e diplomës? Çfarë lidhje ka punësimi i avokatit me akreditimin ose jo? Kjo është detyrë e subjektit privat. Avokati punon ose jo është i siguruar ose jo, është i licencuar institucioni ku punon, këto po mund të jenë kritere për t'i vënë, por unë them të mos bëjmë lapsuse, unë nuk mund të them të konfundojmë kushtëzimin e ligjit të arsimit të lartë me avokatin. Pse zoti Adnor, çfarë detyrimi ka punëmarrësi që t'i thotë atij: “Më jep të gjitha programet, i ke akredituar, apo jo.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, aq sa është, dy vjet. Nuk mund t'i ndërpresësh mundësinë e punësimit një avokati, në një institucion, i cili nuk është akredituar ende. Mos e konfondo, të lutem, idenë e akreditimit me funksionimin ligjor të një institucioni. Mjafton që Institucioni i Arsimit të Lartë funksionon në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Ta heqim termin “akreditim”. Për këtë kërkoj mirëkuptimin e të gjithëve.

Ulsi Manja - Ka një koment nga Dhoma për këtë që thotë kolegu Hyseni?

Maksim Haxhia – Kjo është çështje debati, pozicionimi për ne nuk ka shumë rëndësi. Për ne ka rëndësi që nesër, në qoftë se ndryshojmë pozicionin me ligj, edhe pse është, nuk na...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Problemi është që pedagogët që janë atje janë të nivelit më të lartë. Kështu që edhe pse e vëmë, nuk ka ndonjë problem.

Për pikën 2, kam një sugjerim të vogël ku flitet për avokatët e punësuar në subjektet private, të cilët, krahas punësimit në këto subjekte, duan të ushtrojnë edhe profesionin e avokatit. Këtu ka një problem që duhet të shihet nga ana juaj si ligjvënës, sepse ekziston rreziku i punësimit në të zezë dhe shmangia nga pagesa e tatimeve për çështjet që ata përfaqësojnë. Kështu që mendoj se duhet shtuar edhe kjo duke vënë Dhomën në dijeni me shkrim, para fjalisë së fundit, aty ku thuhet “zbatimi i detyrave të avokatit sipas ligjit”, duke vënë në dijeni me shkrim Dhomën, që ajo ta ketë të kontrolluar këtë veprimtari edhe për shkak të punës në të zezë, por njëkohësisht sepse ne raportojmë te Tatimet se cilët janë avokatët. Tatimet duhet ta vjelin fitimin e këtij kolegu që është i punësuar *full-time* në një subjekt privat juridik.

Ulsi Manja -A mund ta bëni riformulimin për pikën 2, që ta lexojmë për kolegët?

Maksim Haxhia – “Avokatët e punësuar pranë subjekteve private mund të ushtrojnë profesionin e avokatit vetëm në bazë të një marrëveshjeje me shkrim të lidhur për këtë qëllim,

ndërmjet avokatëve dhe subjektit privat, për të siguruar detyrat e avokatit sipas ligjit, (kurdoherë) ose (duke vënë në dijeni Dhomën e Avokatisë)”.

Ulsi Manja -Për pikën 2 të nenit 7, relatori dhe këshilltarët, ju lutem, mbani shënim që të riformulohet në formën e duhur propozimi i kryetarit të Dhomës.

Dua një mendim edhe nga misioni EURALIUS, edhe nga Ministria e Drejtësisë, lidhur me sugjerimin që bëri kolegu Hyseni për përdorimin e termit “akreditim” apo “licencim”.

Agnes Bernhard - *(përkthen përkthyesi)*Jemi dakord me propozimin.

Ulsi Manja - Dakord me nenin 7 për sugjerimet e bëra për pikën 1.

Maksim Haxhia – Kjo e gjen vendin këtu: “duke vënë me shkrim për këtë qëllim ndërmjet avokatit dhe personit privat dhe Dhomën e Avokatisë për të...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e lexoj kështu: “Avokatët e punësuar pranë subjekteve private mund të ushtrojnë profesionin e avokatit vetëm në bazë të një marrëveshjeje me shkrim të lidhur për këtë qëllim ndërmjet avokatit dhe punëdhënësit, si dhe Dhomës së Avokatisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka! “dhe Dhomën”. Mbas “punëdhënësit privat”, do të shtojmë edhe “Dhomën e Avokatisë”.

Ulsi Manja - Bëjeni riformulimin, pastaj e hedhim në votim nenin 7, me sugjerimet e bëra nga kolegu Hyseni për pikën 1 dhe Dhoma për pikën 2.

Do t’ju kërkoja mirëkuptimin për çerek ore pushim!

(Pas pushimit)

Ulsi Manja - Ju lutem!

Të hyjnë mediet!

Rifillojmë mbledhjen e komisionit. Vazhdojmë me nenin 7.

Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia - Te fjalja e fundit, ku thuhet : “ Punëdhënësi privat” të shtohet: “ Kopje e marrëveshjes të depozitohet pranë Dhomës”. Meqenëse flitet për marrëveshje të bërë midis tij dhe subjektit, atëherë një kopje e marrëveshjes të depozitohet pranë Dhomës.

Ulsi Manja - Po, dakord me sugjerimin e bërë nga Dhoma. Kush është dakord me nenin 7 me sugjerimet e bëra nga kolegu Hyseni dhe nga Dhoma? Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 8.

Po, relatori.

Adnor Shameti - Varianti integral i paraqitur ka gjetur dakordësinë e Dhomës Kombëtare, Ministrisë së Drejtësisë dhe EURALIUS-it.

Alket Hyseni - Zoti kryetar, gjetëm rastin të diskutojmë pak edhe në pushim me relatorin, por edhe me përfaqësuesit e Dhomës, ramë dakord se është shumë esenciale t'i kemi të ndara detyrat me ndalesat dhe konfliktin e interesit, pra konflikti i interesit dhe pengesat ligjore të jenë nen më vete. Shumë më e rëndësishme është parashikimi i germës "g" të këtij neni që është konfidencialiteti si një nga parimet më të rëndësishme të avokatisë, ai duhet të jetë nen më vete dhe i riformuluar, sepse është riformuluar keq.

Fjalja e dytë: "Avokati ka të drejtë të kërkojë respektimin e konfidencialitetit edhe nga avokatët e tjerë", kjo është opsionale, se nuk mund të rrijë në dorën e avokatit, kjo është e detyrueshme. Konfidencialiteti është parim shumë i rëndësishëm, i padiskutueshëm, mbrohet në shumë vende edhe me Kushtetutë. Ne nuk e kemi në Kushtetutë, por do ta vendosim në ligj. Propozimi im konsiston në 3 elemente: të ndajë pjesën e parë, pengesat ligjore dhe konflikti i interesit nen më vete, duke pasur parasysh disa korrigjime në formulim, të cilat ose mund t'i bëjmë tani, ose, për shkak të teknikës legjislative mund t'ia lëmë relatorit, këshilltarëve se ka nevojë për një rregullim të mëvonshëm, për togfjalësha, rregullime leksikore dhe gjëra të tilla.

E dyta, përcaktimi i qartë i nenit më vete, i bie neni 9. "Pengesat ligjore dhe konflikti i interesit" është titulli. Të parashikojë që nga germa "e": "Ndalohet të përfaqësojë një klient në një çështje. Ndalohet të përfaqësojë një klient kur ka mbrojtur më parë". Këtu, në vazhdim të propozimit, të shtohet një pikë e përgjithshme: "Në çdo rast tjetër të konfliktit të interesit të përcaktuara nga Dhoma Kombëtare". Nuk mund të shkelim ligjin.

Ulsi Manja - Zoti Hyseni, të lutem, t'i marrim gjërat me radhë!

Ka një propozim për ndarjen e nenit 8 në 3 nene. Formuloni titullin e nenit të parë dhe të dytë. Konfliktin e interesit, në mos gaboj...

Alket Hyseni - Neni 1 "Detyrat e avokatit" të qëndrojë siç është, por germa "ç" hiqet nga neni 8 dhe shkon në nenin që do ketë të drejtat. Germa "ç" hyn tek të drejtat, garanton pavarësinë dhe autonominë e tij.

Ulsi Manja – Pra, titullin e këtij neni.

Alket Hyseni - Titulli ai që është: "Detyrat e avokatit".

Ulsi Manja- Jam i qartë për këtë.

Alket Hyseni - Neni 9, si titull do të jetë: “Pengesat ligjore dhe konflikti i interesit”. Janë të ndryshme, pengesa ligjore është tjetër gjë, kur ke mbrojtur një çështje më parë është pengesë ligjore, kurse konflikti i interesit është kur ti me palën kundërshtare të klientit tënd mund të kesh një lidhje, mund të jesh partner, kushëri, mund të jesh bashkëpronar që të bën të jesh në konflikt interesi. Janë dy nocione të ndryshme.

Ulsi Manja - Për çështjen e konfliktit të interesit propozohet një nen 8/1. Pastaj për efekt të renditjes së neneve, këshilltarët të mbajnë shënime për të bërë renditjen në fund të të gjithë neneve.

Alket Hyseni - Titulli do të jetë: “Pengesat ligjore dhe konflikti i interesit”. Janë dy nocione të ndryshme. Germat do të fillojnë nga “e”-ja, “ë”-ja, “f”-ja dhe “g”-ja. Kam një propozim për t’u shtuar edhe një germë, duke thënë: “Dhe çdo rast tjetër konflikt interesi të parashikuar nga statuti i Dhomës”.

Te neni 8/1, kjo të jetë pikë më vete. Shtohet një pikë këtu.

Pas “g” shtohet një pikë, se nuk do të jetë “g”, por do të jetë “a”, “b”, “c”, “d”, se janë në një nen më vete. Do të shtohet “e” .

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, për ekonomi kohe, e lëmë të hapur nenin 8, bëni riformulimet përkatëse dhe ne ecim përpara.

Kështu që neni 8 ngelet i hapur për t’u ulur relatori, kolegu Hyseni dhe Dhoma. Në parim jemi dakord me këtë logjikë.

A ka sugjerim tjetër për nenin 8?

Po, Ministria e Drejtësisë.

Adrian Shega– Kemi sugjerim për sa i përket pikës “l”, e cila parashikon raportim përpara Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë për çdo dyshim të lindur në lidhje me masën e vigjilencës për futjen në legjislacionin në fuqi për parandalimin dhe pastrimin e parave.

Duke qenë se vetë legjislacioni parashikon që avokatët raportojnë vetë tek autoriteti përgjegjës, që është Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, mendoj se është e panevojshme të raportojnë edhe para Dhomës, duke qenë se vetë legjislacioni specifik i jep Dhomës autoritet mbikëqyrës. Në këto kushte, mendoj se paragrafi “përpara Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë”, mund të hiqet dhe të mbetet “raporton çdo dyshim të lindur në lidhje me masat e vigjilencës”.

Ulsi Manja – Te cila germë është kjo?

Adrian Shega – Germa “l”: “

Raporton përpara Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë për çdo dyshim të lindur në lidhje me masën e vigjilencës për futjen në legjislacionin në fuqi për parandalimin dhe pastrimin e parave”.

Se i bie të raportojnë dy herë avokatët...

Ulsi Manja – Dakord?

Maksim Haxhia – Dakord, se kjo e bën Dhomën pastaj të parashikojë dhe të ndërtojë struktura të posaçme dhe kështu shpërndahet edhe përgjegjësia. Kështu që avokati e ka të fokusuar detyrimin vetëm përpara këtij institucioni.

Ulsi Manja – Dakord atëherë me këtë sugjerim të Ministrisë së Drejtësisë për germën “1”.

Po misioni EURALIUS a ka sugjerime për nenin 8?

Tedi Dobi – Po, kemi një sugjerim. Sugjerimi ynë është që t’i shtohet një detyrë tjetër avokatit, e cila do të lidhet me direktivën për viktimat dhe të ishte që avokati detyrohet të informojë viktimën për të drejtat e saj në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

Ulsi Manja – Po ky është detyrim procedural.

Maksim Haxhia – Për sa kohë avokati përfaqëson interesat e viktimës, ai ka të njëjtin pozicion dhe të njëjten marrëdhënie, si dhe me klientët që nuk janë trajtuar në pozicionin e viktimës.

Ulsi Manja – Këtë e kemi rregulluar te Kodi i Procedurës Penale, në mos gabo, për të drejtat e viktimave.

Maksim Haxhia – Ato janë detyrime universale, prandaj s’ke pse e specifikon vetëm për viktimën.

Ulsi Manja – Gjithsesi, për nenin 8 kolegët dhe këshilltarët të mbajnë shënim, të ulen, të bëjnë riformulimet përkatëse, e lëmë të hapur që ta votojmë herën tjetër.

Vazhdojmë me nenin 9, “Të drejtat e avokatit”.

Adnor Shameti – është varianti i paraqitur në draftin integral. Është i dakordësuar me Dhomën, ministrinë dhe EURALIUS-in.

Ulsi Manja – Urdhëroni zonja Xhina!

Elena Xhina - Faleminderit!

Nisur nga praktika e avokatëve dhe personalisht edhe jona, që jemi të pranishëm sot në komision, ka ndodhur që në momentin kur avokati shkon në dhomat e paraburgimit për të kontaktuar me klientin e sapondaluar apo të sapoarrestuar, ndodh që kërkohet patjetër një autorizim nga prokurori i çështjes, nga forcat e komisariatit të policisë. Kjo ka dalë si pengesë dhe ka bërë shpeshherë të pamundur që avokati të takohet me klientin dhe janë takuar bashkë vetëm në sallën ku merret masa e sigurimit.

Në këto kushte, meqenëse kemi mundësi ta rregullojmë këtë gjë në këtë projektligj, propozoj që në pikën “c”, ku parashikohet të takohet vetëm për vetëm avokati me klientin përpara marrjes në pyetje për herë të parë, të shtojmë një fjali, e cila t’i japë mundësinë avokatit të mos kërkojë autorizim nga prokurori për takimin me klientin.

Konkretisht propozimi im do të ishte që në fund të fjalisë “të takojë vetëm për vetëm klientin përpara marrjes në pyetje për herë të parë dhe të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose të ndalimit të klientit”, të vazhdojë me një fjali tjetër: “Institucionet e policisë apo të vuajtjes së dënimit janë të detyruara ta realizojnë këtë të drejtë pa pasur nevojë për autorizim të posaçëm nga prokurori”.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Ky propozim mund të vlejë ta fusim këtu ose në nenin e mposhtëm, nenin 10 “Të drejtat dhe detyrimet e organeve të tjera”, mund ta fusim edhe aty, në pikën “c”. Këtë një. E dyta, të mos harrojmë propozimin që bëra më parë, që pika “ç” e nenit 8, që ishte, pra: “Garantimi i pavarësisë” hyn te të drejtat, futet këtu, në këtë nen. Të kalojë siç është, Pra: “Garanton pavarësinë dhe autonominë e tij gjatë ushtrimit të profesionit” hyn te të drejtat, ndaj hiqet formulimi...

Ulsi Manja – Pra, germa “ç” e nenit 8 të kalojë tek të drejtat e avokatit, te neni 9.

Alket Hyseni – Duke u formuluar, ka të drejtën e pavarësisë dhe autonomisë gjatë ushtrimit të profesionit. Kjo është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Maksim Haxhia – Nëse e kuptova deputeten, e kishte fjalën që të mos komplikohen procedurat dhe ecejaket e avokatit duke shkuar te prokurori, por me kërkesën më të parë të klientit.

Ulsi Manja – Për takimin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë mund ta kalojmë te neni 10.

Maksim Haxhia – Ndalohet shtetasi, për shembull, dhe thotë: dua filan avokat. Shkon avokati atje dhe i thonë: jo do të shkosh te prokurori. Në atë moment ai ka shprehur dëshirën, dhe në moment avokati përpilon edhe një autorizim me shkrim, derisa të fillojë marrja në pyetje.

Ulsi Manja – Po.

Relatori.

Adnor Shameti – Në vijim të diskutimeve të kolegëve, do të sugjeroja që ta rregullojmë me teknikën, bashkërisht, këtë kërkim që lidhet me kontaktin e parë të avokatit me të pandehurin, dhe duhet ta lidhim ekskluzivisht vetëm me dhënien e pëlqimit të të pandehurit. Pastaj janë të detyruar të gjitha organet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur themi i pandehuri, edhe familjarët e tij...

Ulsi Manja – Duke zbatuar rregullat e procedurës penale.

Adnor Shameti – Rregullat e procedurës penale. Kjo është ideja.

Ulsi Manja – Ky është sugjerimi.

Adnor Shameti – Pa qenë nevoja të ketë autorizim të posaçëm.

Ulsi Manja – Po, faleminderit, zoti Shameti.

Zonja Felaj,

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Manja!

Germa “c” e nenit 9 më krijon problem vetëm nga ana gjuhësore, e pastaj edhe nga ana përmbajtësore ndajfolja “përpara”: “të takojë vetëm për vetëm klientin, përpara marrjes në pyetje për herë të parë”, që do të thotë se prokurori duhet të presë deri kur të vijë avokati...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Të lutem!

Ermonela Felaj – Një minutë, të lutem!

Prokurori shkon të marrë takim me të ndaluarin ose të arrestuarin. Gjëja e parë që bën është ta pyesë nëse ka mbrojtës ose jo, nëse kërkon të zgjedhë mbrojtës ose jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se ai thotë që nuk dua mbrojtës dhe as nuk dua të përfitoj nga mbrojtja, ky nen këtu nuk mund ta kondicionojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prokurori është i detyruar që, pasi i ka lexuar të drejtat, të ndërpresë pyetjet në momentin kur ai të thotë se do avokat dhe se do këtë apo atë avokat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Dakord. E pyet nëse do avokat dhe cilin do, e pastaj e lajmëron. Nëse thotë se do të mbrohet vetë, mbahet procesverbali, ai e firmos dhe vazhdohet me pyetjet.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Kjo kërkon patjetër një qartësim. Kolegia Felaj ka të drejtë. Mund të shtojmë termin “kur”, kur kërkohet mbrojtje nga klienti. Por, unë kam një rezervë. Nuk mund të formulohet e klienti do të takohet vetëm për vetëm veç herën e parë. Duhet të shtojmë edhe:

“në çdo fazë të hetimit apo të procesit”, sepse këtu lihet të nënkuptohet se e takon vetëm për vetëm veç herën e parë, gjithë q bie ndesh me parime të rëndësishme, që avokati...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Alket Hyseni – Unë jam dakord që Kodi i Procedurës ka parime, është një nivel më lart dhe prevalon, por ne po bëjmë një ligj specifik për avokatin, ku po japim të drejtat e tij. Jemi pikërisht te neni i të drejtave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të tre këta nene që përmendëm, që janë nenet 8, 9 e 10, duke qenë se do të ketë merr andej e merr kënde, ta shtyjme miratimin sot, për t’i dhënë kohë relatorit, dhomës dhe propozuesve, e të kalojmë tek neni 11, që është më i thjeshtë...

Ulsi Manja – Ju lutem!

Nëse do të lëmë të hapura 8-ën, 9-ën e 10-ën, sigurisht që edhe 11-a do të mbetet se do të mbetet e hapur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë s’e lëmë të hapur nenin 9, për të bërë riformulimin e duhur për germën “c”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë të kalojmë te neni 10: “të drejtat dhe detyrimet e organeve të tjera”,

Adnor Shameti – Varianti i paraqitur është i dakordësuar me dhomën, Ministrinë e Drejtësisë dhe misionin EURALIUS.

Ulsi Manja – A keni vërejtje për nenin 10?

Alket Hyseni - Do të bëjmë riformulimin: “Lejimi i avokatit të takojë klientin e tij në momentin më të parë të kufizimit, pa autorizim të organeve, përveç miratimit të klientit ose familjarëve të tij”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Jemi të neni 10.

Alket Hyseni – Janë spostuar.

Ulsi Manja – Nenin 9 e kaluam, e lamë të hapur.

Te neni 10 janë “Të drejtat dhe detyrimet e organeve të tjera”. A është dakord me nenin 10, Dhoma? Po Ministria?

(Diskutime pa mikrofon)

Alket Hyseni – Më fal, zoti kryetar, neni 10 “Të drejtat dhe detyrimet e organeve të tjera, germa “c”...

Ulsi Manja – Doni ta kaloni te neni 10?

Alket Hyseni – Ai do ta ndërrojë numrin, po në germën “c” duhet bërë ndryshimi që thashë, pra kjo shtesë.

Ulsi Manja – Po, pra, germën “c” e kemi të neni 9.

Alket Hyseni – Jo, është tjetër germë ‘c’ kjo këtu, është tjetër germë “c” ajo atje: “Të takojë vetëm për vetëm klientin...”

Ulsi Manja – “Garantimin e takimit të avokatit vetëm për vetëm me klientin përpara marrjes në pyetje për herë të parë tij dhe vënien në dispozicion të akteve, provave dhe arsyeve të arrestimit ose ndalimit të klientit”. Çfarë propozohet për këtë konkretisht?

Alket Hyseni – Ai është neni 9. Unë e thashë propozimin. Aty do të shtohet...

Ulsi Manja – Është neni 10, nuk është neni 9 ky që lexova unë.

(Diskutime pa mikrofon)

Alket Hyseni – Dakord, por është edhe kjo 10-të, por ke edhe 10, citim i titullit, se ka një lapsus.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A jemi të neni “Të drejtat dhe detyrimet e organeve të tjera”, apo jo?

Ulsi Manja – Jo, e kemi kaluar këtë.

Jemi tek neni 10 “Të drejtat dhe detyrimet e organeve të tjera”.

Alket Hyseni – Po, pra neni 10, germa “c”. Shikojeni pak germën “c”.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk mund të qëndrojë me këtë formulim. Duhet të riformulohet.

Ulsi Manja – Atëherë, neni 10 “Të drejtat dhe detyrimet e organeve të tjera”.

Po, Ministria e Drejtësisë.

Adrian Shega – Për sa i përket pikës 2 të nenit 10, është parashikuar që avokati ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatave administrative kompetente, ndërkohë që në pikën 1 përcaktohet se institucionet që duhet të japin janë edhe subjektet private. Ideja është: a mund të ngrihet një padi ndaj një subjekti privat në Gjykatën Administrative për dhënie informacioni? Mos ndoshta duhet të parashikohet në gjykatën civile vetëm për këtë rast.

Ulsi Manja – Po, relatori.

Adnor Shameti – Zoti kryetar, keni pasur një diskutim të gjatë në lidhje me këtë çështje dhe varianti i paraqitur në pikën 2 të nenit 10 ka gjetur mbështetjen dhe miratimin e Dhomës dhe të misionit EURALIUS, pasi është e domosdoshme që të vihen para përgjegjësisë të gjitha organet e administratës shtetërore që të zbatojnë detyrimin ligjor për t’i vënë në dispozicion çdo avokati materialin e kërkuar. Duhet të lidhet me një afat të caktuar, se nuk mund ta lësh të hapur gjatë gjithë kohës, në të kundërt nuk garantohet e drejta e mbrojtjes.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Po, Ministria e Drejtësisë.

Adrian Shega – Ideja ishte që, duke qenë se do të kërkojë informacion avokati dhe i paditur do të jetë një subjekt privat, a mundet që padia të ngrihet në Gjykatë Administrative?

Ulsi Manja – Po, Dhoma.

Maksim Haxhia – E ka zgjidhur Kodi i Procedurës Civile, pra për çështjet në konflikt civil avokati i kërkon gjykatës edhe detyrimin e palës për të sjellë X provë apo shkresë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Edhe EURALIUS- ka për të shtuar diçka.

Maksim Haxhia – Kjo është për subjektin civil, kurse për subjektin administrativ është ajo që tha relatori.

Ulsi Manja – Po, EURALIUS.

Tedi Dobi – Në lidhje me pikën 2 nuk kemi koment, por kemi një sugjerim për germën “a” të pikës 1, ku sugjerojmë të thuhet: “Janë të detyruara të plotësojnë kërkesat e ligjshme kur kanë lidhje me: “Vënien në dispozicion të avokatit brenda një afati të arsyeshëm informacionet e kërkuara prej tij, nëse nuk është parashikuar ndryshe në ligj.

Ulsi Manja – Te germa “a”: “...të kërkuara prej tij, nëse nuk është parashikuar ndryshe në ligj.”

Atëherë, jemi dakord me sugjerimin për germën “a” të pikës 1.

Ju lutem, a ka mundësi ta mbyllim diskutimin për pikën 2, sepse kemi gjysmë ore që nuk kemi votuar asnjë nen?

Alket Hyseni – Me sa kuptova, Ministria kishte një ndërhyrje të drejtë. Ministria nuk e kishte për formulimin, por për gjykatën kompetente. A mund të jetë Gjykata Administrative kompetente për ente private apo për subjekte private? Kam shqetësimin që po e ngarkojmë Gjykatën Administrative me çështje pafund, sepse duke i rënë shkurt, kjo sjell edhe një mbingarkesë. Ndërkohë, çfarë sensi ka, se një subjekt privat është subjekt i gjykatës civile dhe jo i asaj administrative?! Për gjithë pjesën tjetër është në rregull Gjykata Administrative, për gjykatat, për prokurorinë, për noterët, për përmbauesit, për organet e Policisë së Shtetit, për entet publike, por kur vijmë te subjektet private, dyshoj të jetë në kompetencë të saj. Gjithsesi, do të na e sqarojë relatori gjatë diskutimeve se çfarë është.

Ulsi Manja – Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Sipas objektit dhe palëve, në Gjykatën Administrative paditës ose i paditur është gjithmonë shteti, kështu që nuk ke te bësh me një çështje për të cilën duhet t'i drejtohesh subjektit privat. Subjekti privat është gjithmonë paditës ose i paditur në një konflikt civil. Kështu që vetë gjykata atje me kërkesën e avokatit e detyron subjektin ta...

Ulsi Manja – Këto gjëra kanë gjetur zgjidhje në Kodin e Procedurës Civile, nuk mund ta zgjidhim me një ligj për avokatinë nëse është Gjykata Administrative apo Gjykata Civile.

Maksim Haxhia – Është natyra e çështjes që bën edhe obligimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- E lëmë gjykatën kompetente: “të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente”, e heqim fjalën dhe e lëmë “gjykatën kompetente” dhe çështjen e gjykatës kompetente ta zgjidhë Kodi i Procedurës Civile. Kjo është e qartë.

Kush është dakord me sugjerimet e bëra për nenin 10? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11. Fjalën e ka relatori.

Adnor Shameti – I nderuar zoti kryetar, meqenëse ditën e premte është caktuar një tryezë për saktësimin përfundimtar të qëndrimit që do të mbajmë lidhur me provimin e shtetit për profesionin e juristit, sugjeroj që nenin 11 ta lëmë të hapur dhe ta diskutojmë përfundimisht me dy-tre nenet e tjera që i kemi lënë të hapura.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Lidhur me pjesët e tjera të nenit 11, duke përjashtuar pikën 2, germën “c”, që lidhet e me provimin e shtetit, a jeni dakord?

Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Shoh germën “dh” të nenit 11 “Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë” dhe dy nëngermat “i” dhe “ii” janë të tepërta, sepse “i dënuar” quhesh kur je dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe i padënuar quhesh kur je rehabilituar, ndërkohë që je dënuar. Kështu që ky lloj sqarimi është i tepërt, sepse në Kodin Penal janë nocione të sakta dhe nuk kanë nevojë të zërthehen këtu. Ashtu edhe për nëngermën “iii”, do të preferoja që të kemi një listë të neneve, për të cilat je dënuar, je rehabilituar dhe mbrapa nuk mund të ushtrosh më profesionin e avokatit. Është pak larg si krahasim, por unë them të mbahet edhe një balancë me ligjin e dekriminalizimit, i cili ndalon të zgjedhurit dhe funksionarët publikë, që për një kategori veprash të caktuara të mund të ushtrojnë funksionet e tyre, edhe kur e kanë mbaruar dënimin, edhe kur janë rehabilituar.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Felaj!

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në bashkëpunim me misionin EURALIUS, Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë ne kemi bërë një analizë të thelluar dhe të detajuar për gjuhën që është paraqitur në draft lidhur me gjerat “dh” dhe “e” të nenit 11 të ligjit për avokatinë dhe kemi

gjetur dakordësi për përkufizimet dhe përcaktimet në këtë nen, të cilat mendojmë se janë të domosdoshme.

Ermonela Felaj – Pse janë të domosdoshme?

Adnor Shameti – Këtu janë përcaktuar dispozitat dhe rastet kur nuk mund ta ushtrojë.

Ermonela Felaj - Për germën “dh” dhe nëngermën “iii” duhet të kishit një listë të neneve, që njerëzit dënohen, kryejnë dënimin dhe rehabilitohen dhe nuk mund ta ushtrojnë profesionin e avokatit. Dy nëngermat sipër “i” dhe “ii” janë komplet pa vlerë, sepse po të shkruhet “të mos jetë dënuar” është e qartë dhe nuk kemi pse t’u futemi diskutimeve “vepër penale me dashje”, “vepër penale nga pakujdesia” dhe “rehabilitim”.

Ulsi Manja – Ju lutem, të jemi racionalë, sepse këto janë diskutime juridike. Germa “dh” synon të bëjë dallimin mes dënimit dhe rehabilitimit, ku nëngërma “i”, ka dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe nëngërma “ii” rehabilitimin. A ka mundësi relatori dhe Dhoma të më tregojnë se çfarë keni pasur në konsideratë kur keni shtuar...

Adnor Shameti – Kemi të bëjmë me të drejtat kushtetuese të një subjekti të posaçëm, që në këtë rast është avokati, dhe me përjashtim të këtyre rasteve, që i kemi përcaktuar në germën “dh” dhe nëngermat “ii” dhe “iii”, në të gjitha rastet e tjera nuk ka asnjë pengesë. Instituti i rehabilitimit është i parashikuar për këto vepra penale që kemi specifikuar dhe në të gjitha rastet e tjera nuk ka asnjë pengesë ligjore. Te nëngërma “iii”, që me të drejtë zonja Felaj kërkon identifikimin e veprave, i lihet Dhomës Kombëtare të Avokatëve atributi për të identifikuar ato vepra që cenojnë integritetin personal dhe profesional të avokatit, ku Dhoma përcakton rast pas rasti nëse legjitimohet ose jo për të pasur licencë të avokatit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Fjalën e ka zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Ne kemi pasur një ide më koncize lidhur me këtë, por në diskutime me EURALIUS-in dhe me relatorin është vënë ky variant. Ne kemi qenë me variantin, që për të ushtruar profesionin e avokatit duhet të ruhet gjithmonë parimi midis lirisë së profesionit, integritetit dhe dënueshmërisë dhe kemi qenë dakord me këtë formulim: “Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për të gjitha ato vepra penale, rrethi i të cilave përcaktohet në statut”, sepse “me dashje” është edhe drejtimi i automjetit në gjendje të dehur dhe nuk ka sens. Meqenëse teknikën legjislative nuk mund ta parashikojmë këtu, atëherë formulimi mund të ishte: “përcakton vetëm veprat penale, rrethi i të cilave përcaktohet në statut” dhe për ne kjo mbyllet.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Zoti kryetar, ne ramë dakord që këtë nen ta shikojmë të premtën, meqenëse ka një diskutim tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse po t'i hyjmë diskutimit të kësaj, edhe unë kam dy sugjerime për këtë nen, madje e kam bërë dhe në diskutimin në parim. Në diskutimin në parim kam bërë pyetjen, të cilën e kam bërë edhe më parë: të gjithë këta prokurorë dhe gjyqtarë që dalin nga vetingu të dënuar, a mund të bëhen pjesë e Dhomës së Avokatisë? Unë mendoj se ata nesër nuk duhet ta bëjnë punën e avokatit kur janë larguar nga vetingu. Domethënë “Te detyrat”, përfitimi i avokatit, realisht, duhet të jetë i shkruar në këtë nen, se nuk është i shkruar. E para.

Së dyti, e thashë edhe më parë, aty ku thuhet: “...të ketë përfunduar me sukses provimet e shtetit”, hiqini fjalët “me sukses” dhe “pa sukses”.

Ulsi Manja – Këtë do ta diskutojnë të premtën.

Bashkim Fino – Çfarë do të thotë kjo “me sukses”? Kush e ndan këtë “me apo pa sukses”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se ka përfunduar dhe merr licencën, le ta marrë, ta gëzojë. Ku është kjo “me sukses” dhe “pa sukses”? Këtë nen ose do ta lëmë, ose hajdeni të bëjmë një diskutim në thellësi, sepse kam shumë vërejtje për nenin përkatës.

Ulsi Manja – Në rregull.

Atëherë, nenin 11 e lëmë të hapur për shkak edhe të...

Urdhëroni, EURALIUS-i!

Tedi Dobi – Ne si mision, EURALIUS-i, duke bërë një analizë të thelluar të të gjithë legjislacionit europian, sugjerorjmë të shtojmë një kriter te lista e kriterëve për përfitimin e titullit avokat, i cili do të ishte: “Avokati nuk është shkarkuar nga një funksion publik me vendim të organit disiplinor kompetent”. Kjo është në linjë edhe me vendet e tjera.

Ulsi Manja – Po masa disiplinore e parashkruan, por gjithsesi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Hyseni, ta mbyllim diskutimin dhe për këtë propozim të EURALIUS-it.

Urdhëroni!

Adnor Shameti - Zoti kryetar, mendoj se nuk duhet të parashikojmë një paragraf të tillë, sepse bien parimet dhe shtyllat e ligjit mbi profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë dhe nuk mund të bëhet profesioni i avokatit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, paradhomë e një institucioni çfarëdo të administratës publike. Në mënyrë kategorike, jo!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Urdhëroni!

Maksim Haxhia – Pa kaluar në detaje dhe në elemente të ligjit, vetëm duke ndenjur te parimi, profesioni i avokatit është një profesion i lirë dhe nuk është i kushtëzuar fare nga

qëndrimi që do të mbajë një person, i cili do të bëhet avokat në punët që ka pasur para se të bëhej avokat. Për mua vetëm një gjë duhet të kihet parasysh: në profesionin e avokatit nuk do të vijë ata juristë, të cilët nga e kaluara e tyre e provuar dhe e fiksuar me vendim të gjykatës, nuk kanë moral të ushtrojnë profesionin e avokatit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nuk kemi pse ta zgjasim shumë.

Maksim Haxhia – Për shembull, një përdhunues, një pedofil apo një vrasës serial, këta janë persona që nuk duhet të hyjnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Për të njëjtat arsye që thashë, neni 11, i cili ka të bëjë me fitimin e titullit të avokatit, meqenëse kemi një problem të pambyllur në lidhje me germën “c” “me provimin e shtetit”, do të hyjë te nenet që do t’i diskutojmë në mbledhjet e radhës. Kështu që ngelet i hapur.

Kalojmë te neni 12 “Kushtet për ushtrimin e profesionit të avokatit”.

Urdhëroni!

Adnor Shameti – Zoti kryetar, varianti i paraqitur përpara jush është i dakordësuar me misionin e EURALIUS-it, me Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

Ulsi Manja – Fillojmë me radhë.

A jeni dakord ju të ministrisë?

Adrian Shega – Dakord.

Ulsi Manja – A është dakord EURALIUS-i?

Tedi Dobi – Dakord.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 12, sipas variantit që paraqitet në tekstin integral?

Nuk ka problem, zoti Hyseni, sugjeroheni, se e mbajnë shënim këshilltarët.

(Zoti Hyseni flet pa mikrofon)

Kush është dakord me sugjerimin e kolegut Hyseni? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 12.

Kalojmë te neni 13 “Organizimi i avokatëve”.

Adnor Shameti - Varianti integral i paraqitur në nenin 13 është i dakordësuar me misionin EURALIUS, me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, si dhe me Ministrinë e Drejtësisë.

Ulsi Manja – Ju lutem, shprehuni me radhë, a jeni dakord?

Adrian Shega– Dakord.

Ulsi Manja – A është dakord EURALIUS-i?

Tedi Dobi - Dakord.

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Mendoj se pika 4 është shkelje e të drejtave. Thamë se do ta lejojmë avokatin që të organizohet individualisht dhe si subjekt. Ne nuk mund të ndalojmë subjekte të tjera, që nuk kanë licenca. Pra, ai mund të ngrihet si subjekt, por për të punuar si avokat aty, do të punojë vetëm avokati i licencuar, por jo që të mos hapë biznesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ashtu thuhet: “Pa pajisur me licencë aktive”, pra “Krijimi i studiove, ku kanë aksione ose kuotat, pjesëmarrje personat pa pajisur me licencë aktive”. Jo, mund të jetë një shoqëri e krijuar nga një person, që nuk do ta ushtrojë kurrë vetë avokatinë, por rekruton avokatët më të mirë, ti do ta ndalosh?! Është subjekti juridik, bie ndesh me të drejtën tregtare. Kështu që pika 4 nuk duhet të qëndrojë.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Haxhia!

Maksim Haxhia – Problemi është se licencimi i studiove është i kontrolluar nga Dhoma. Ka edhe një regjistër të posaçëm për avokatët edhe si subjekte fizik, si individual edhe si studio. Në studiot ne kemi përcaktuar rregullat, që krijohen vetëm nga avokatët, madje edhe emri i studios duhet të jetë vetëm me mbiemrat e avokatëve, por jo të tjerë aksionerë të vijnë të futen në studio. Kanë aktin e themelimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Fjalën e ka relatori për një mendim dhe pastaj ju, zoti Hyseni.

Adnor Shameti – Në vijim të asaj që sqaroi përfaqësuesi i Dhomës, unë jam në mbështetje të përcaktimit të bërë në paragrafin e katërt të nenit 13, sepse parashikimi i një përcaktimi të tillë në nenin 13 i ndihmon, nga njëra anë, për shmangien e konkurrencës së pandershme në profesionin e avokatit dhe, e dyta, për shmangien e influencave. Domethënë, po ta përmbledhësh, rasti “Ngjela” në avokati, kjo është, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë kemi parasysh në përcaktimin dhe në diskutimet që kemi pasur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Kështu i bie që Republika e Shqipërisë bën shpikjen e radhës, ndryshe nga të gjitha praktikat. Më gjeni një praktikë botërore që e bën këtë! Të mos bëjmë sofizma shqiptare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëri ato tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Alket Hyseni – Zoti relator, lëreni, mor!

Ma jepni përkufizimin. Nuk ka!

Dëgjoni tani! Ndaloni ju një person dhe kërkoni ta lidhni vetëm me licencën, për t'i dhënë Dhomës një akses të pamerituar. Çdo individ është i lirë të krijojë çdo shoqëri.

Së pari, bie ndesh me ligjin “Për shoqëritë tregtare”. Çdo shoqëri e krijuar... Që të ushtrojë veprimtari avokatie pastaj, patjetër, do të rekrutojë avokatë, të cilët do të regjistrohen te Dhoma, do të regjistrojnë edhe zyrën aty. Por nuk mund t'ia kushtëzosh ti kuotat, thua ti, nuk mund të ketë asnjë kuotë, madje nuk mund të ketë asnjë aksion një individ që nuk është avokat. Kjo është shkelje flagrante dhe bëhet qëllimisht!

Unë e shoh të ekzagjeruar këtë dhe kërktoj mirëkuptimin e kolegëve. Nuk ka asnjë praktikë botërore, përkundrazi, mund t'ju jap shembullin e disa shteteve të cilët... Organizimi është i lirë, sepse marrin financime. Do të vijë koha kur studiot avokatore do të kërkojnë financime për pagesën e taksës së padisë, për shpenzime procedurale shumë të shtrenjta. Ti do t'ia ndalosh këtë? Do t'ua lësh avokatëve, apo do t'ia lësh vetëm një kaste, si unë dhe ju, që mund ta kemi krijuar këtë gjë, duke shmangur të tjerët? Kjo për mua është e ekzagjeruar, madje është tipike shqiptare. Janë ato shpikjet që bëjmë ne që, meqenëse po bëjmë një ligj, hajde ta kufizojmë këtu dhe të marrim disa kompetenca.

Jo, nuk mund të bëhet, pasi kjo bie ndesh me parimet e Kushtetutës, me ligjin “Për shoqëritë tregtare” dhe me të gjithë praktikën botërore. Nëse më gjeni një praktikë të kundërt, unë do ta pranoj.

Ulsi Manja – Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Shumë faleminderit!

Tani, e garantoj zotin deputet se nuk ka shpikje shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, por ne për 25 vjet nuk kishim avokati. Edhe kjo pati një të mirë, si çdo e keqe që e ka një të mirë, se kur ne bëmë ligjin “Për avokatinë” në vitin 2013, adoptuam eksperiencat më të përparura, që ishin nën kontrollin dhe ndihmën e Këshillit të Europës. Përveç kësaj, në vitin 2012 bëmë amendamente nën kontrollin e Bashkimit Europian dhe të gjitha këto sa diskutohen dhe janë vendosur këtu, janë të fiksuara, të rregulluara dhe detyruese, në bazë të rregullave të vendosura nga CCBE-ja, që është Këshilli i Dhomave të Avokatisë dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Hyseni!

Maksim Haxhia – ...Studiove Ligjore të vendeve të Bashkimit Europian, ku Dhoma Kombëtare e Avokatisë është anëtare me statusin e vëzhguesit.

Këtu ka një gjë, që duhet ta kemi kujdes, që është edhe parimi, se çdo studio avokatie duhet të krijohet nga avokatë.

Ulsi Manja – Ky është parimi.

Maksim Haxhia – Po, parimi.

Pra, në qoftë se një i jashtëm është, për shembull, jurist, deputet, dhe ka emrin në studio, do të marrë koston e konfliktit të interesave.

Ai mund të jetë anëtar i studios, mund të marrë edhe kuotat, por nuk mund të jetë një biznesmen. Futja e një biznesmeni për të krijuar studio avokatie, sepse abuzohet me të rinjtë. Merr dy-tri avokatë të rinj dhe i mban skllëvër aty, siç bëjnë edhe të huajt...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po përmend studio këtu që marrin vajza dhe djem të rinj, kolegët tanë të rinj, të cilëve ju shfrytëzojnë punën, i vënë emrin e tyre dhe i sjellin klientë, por fitimet i marrin vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është ajo që ne...

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Dakord, parimore.

Ulsi Manja – Ky është qëndrim parimor.

Alket Hyseni – Unë e sfidoj kryetarin e Dhomës të më gjejë një ligj...

(Diskutime në sallë)

Zoti kryetar, po diskutojmë ligjin këtu!

Statusin tënd mbaje, ta gëzosh! Unë jam avokat dhe kam paguar, si ndryshe nga të tjerët, kuota pafund në atë Dhomë dhe kam të drejtat e mia, por sot jam si deputet. Më gjej një ligj kur ti e kufizon këtë të drejtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Italianin?! Më lejo tani...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Unë kam pasur sa të duash partnerë italianë, të cilët nuk janë fare avokatë, nuk e ushtrojnë, por të gjithë punonjësit në zyrë janë avokatë dhe plotësojnë kushtëzimet ligjore.

Tani, të thuash ti që po merr tre skllëvër, këto janë koncepte shqiptare.

Ai mund të marrë tre studentë të Harvardit, dakord, t'i paguajë dhe të bëjë studion më të mirë në vend. Nga se trembesh ti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë mirë, mor zotëri, është ekonomi tregu!

Mbledh më të mirët, por ti i kushtëzon, sepse një i sapodiplomuar nuk mund të marrë me qira ose të blejë një studio, të ketë pajisjet, të paguajë taksat e larta të padisë kur klientët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo pra, nuk e lë dhe kjo është ekonomia e tregut! Përballoje ekonominë e tregut, por jo me rregulla antiligjore dhe antikushtetuese!

(Zoti Haxhia flet pa mikrofon.)

Kjo është shkelje flagrante!

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, faleminderit!

Ka komente nga përfaqësuesja e EURALIUS-it për nenin 13, në variantin siç paraqitet në tekstin integral?

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesi)* Nuk kemi komente për momentin.

Ulsi Manja – Po nga Ministria e Drejtësisë?

Adrian Shega– Nuk kemi komente.

Ulsi Manja – Pra, bini dakord me këtë formulim që ka neni 13.

Adrian Shega – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Po, urdhëroni!

Arben Pëllumbi – Dua të them edhe unë diçka për pikën që po flasim, por jo në rolin e juristit. Unë nuk jam jurist që të di të interpretoj rolin e avokatit në këtë rast dhe si duhet ndërtuar studioja, por marr shkas nga profesionet e tjera si ai i arkitektit apo inxhinierit të ndërtimit.

Një investitor në një kompani mund të punësojë inxhinierë ndërtimi apo arkitektë dhe kompania funksionon. Nuk e di nëse është e njëjta gjë edhe në rastin e avokatisë, por doja ta thosha si shembull. Nëse nisemi nga koncepti i ndërtimit të një shoqërie tregtare, e cila regjistrohet në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë, ajo ka të drejtë të ketë edhe investitorë, që mund të mos jenë juristë. Kështu e shikoj unë këtë gjë. Kështu që, mbështes zotin Hyseni në këtë pikë.

Ulsi Manja – Avokatia nuk është shërbim si gjithë shërbimet e tjera. Unë jam shumë i interesuar për këtë fushë, prandaj dua një mendim nga Dhoma se cilat janë standardet europiane për të atje ku ju aderoni. Sipas këtij koncepti, më falni që po e marr si pikë reference, i bie që Bashkim Fino, që nuk është jurist dhe nuk ka licencë avokatie, të ketë një studio ligjore të vetën dhe të ofrojë shërbime ligjore në një biznes privat ose të jetë aksioner. Avokatia është një lloj shërbimi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht. Prandaj më intereson standardi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Haxhia, a ka mundësi, në përputhje me standardet,....

Ne kemi detyrim përafrimin e legjislacionit tonë me standardet e BE-së. Kështu siç është formuluar neni 13, është konsultuar me variantin ...? E dua përgjigjen nga Dhoma, ministria dhe relatori.

Maksim Haxhia – Jemi në të njëjtën gjatësi vale me CCBE-në dhe EURALIUS-in

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Neni 4, germa “a” : “avokati ushtron ... persona fizik dhe juridik, organizohet si person fizik dhe juridik”.

Kur ti thua se organizohet si person juridik, ...

E dini cili është koncepti i personave juridikë? Mund të jetë një shoqëri aksionere, që mund të ketë 100 mijë aksionerë, të cilët do të futen në bursë siç janë mijëra zyra ligjore në botë: Amerikë, Angli, Itali, Gjermani. E njihni konceptin e bursës? Ju ndaloni të ketë kuota. Mua më duket koncept komunist.

Maksim Haxhia – Hiqjani avokatisë studiot. Ti bëj QKP-ja.

Alket Hyseni – Jo, ti do ta miratosh

Maksim Haxhia - Në asnjë mënyrë. Unë rregulloj profesionin e kolegëve të mi.

Nuk është as *sh.p.k.* dhe as aksionere, por shoqëri e thjeshtë.

Alket Hyseni – Kush të tha?

Maksim Haxhia – Ta them me përgjegjësi dhe kompetencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Unë të respektoj, por konceptin e një personi juridik nuk e përcakton një shoqëri e thjeshtë. Ose mund ta themi, por jemi ndryshe nga e gjithë bota. E ke idenë e studiove ligjore apo jo? Janë subjekte juridike me qindra dhe mijëra aksionerë. Ndryshe nga ata ti po thua do t'i bëjmë vetëm individuale. E di pse i jepet Dhomës miratimi i asaj zyre? Që ti t'i kontrollosh avokatët e atij subjekti juridik. Të jenë të licencuar. Ta pyesësh, cilët janë avokatët që ti ke marrë në punë që të marrësh statusin e studios? Janë të licencuar apo jo? Nuk mund t'i bësh gjë tjetër? Prandaj po ta japim të drejtën ty të kontrollosh në regjistër edhe subjektet juridike. Vetëm Shqipëria i bën këto. Ne po bëjmë shpikje, sepse me kartonë mund të kalohet çdo gjë, por unë do të dal me amendament dhe do të kërkoj mbështetje.

Bashkim Fino – Më shqetëson kur thotë “tipike shqiptare”. Kur thotë “tipike shqiptare” unë jam me të, por kur nuk është “tipike shqiptare” (këtu kemi EURALIUS-in, ministrinë dhe Dhomën, të cilat thonë që studiot e avokatisë marrin dakordësinë nga Dhoma e Avokatisë,

sepse kështu e ka edhe BE-ja), atëherë e lëmë kështu. Nuk kemi pse bëjmë artifice dhe të themi që është tipike shqiptare. Ai është diskutimi tij, ashtu e mendon, ne të tjerët ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë ju dëgjova dhe bile folët disa herë për këtë pikë.

Po qe se është tipike shqiptare, jam me ty (duhet të bëjmë ligje që të afrohem me Europën), por nëse nuk është tipike shqiptare, por konfirmohet nga Dhoma, ministria, EURALIUS-i, që të drejtën e studios së avokatisë e jep Dhoma dhe jo QKR-ja, atëherë ngelet kështu siç është.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, keni formulim konkret?

Alket Hyseni – Kam formulim.

Formulimi i saktë është heqja e pikës 4, sepse është ndaluese. Thotë: “ndalohet krijimi i studiove ku ka aksione ose kuota”. Unë i qëndroj variantit që Dhoma do ta kontrollojë. Çdo person juridik ka të drejtën e kontrollit, të drejtën, që, para se të krijohet, të çojë listën e avokatëve, por jo të ndalojë krijimin e studiove ku kanë aksione ose kuota të pjesëmarrjes së personave pa licencë. Është i vetmi rast..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lexoje! Thuhet: të pa pajisur me licencë aktive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje me mua, por ka lidhje me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka lidhje me licencën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Unë mendoj se në një subjekt nuk duhet të jetë ndaluese, por duhet të jetë kontrolluese. Nuk mund t’i ndalojmë ne investitorët të futen në sektorin e studiove.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po i kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Zotëri, ti ke të drejtë të japësh licencën e studios së avokatisë, por duhet të themi se do të ndalohet krijimi i studios së avokatisë, ku kanë aksione apo kuota pjesëmarrëse, persona të pa pajisur me licencë. Pra, u themi të mos ta bëjnë një gjë të tillë. Ky edhe mund ta bënte, por ne e ndalojmë, sipas kësaj pike të nenit filan. Bëjmë mirë që i

ndalojmë, se nëse nuk i ndalojmë, ky mund të bëjë sa të dojë studio të tilla. Unë jam që të qëndrojë kjo pikë.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Ka një propozim konkret të kolegut Hyseni për ta hequr pikën 4, të nenit 13.

Ky është propozimi, zoti Hyseni?

Alket Hyseni – Po, ky është propozimi.

Ulsi Manja – Meqenëse propozimi i kolegut Hyseni është propozimi më i largët, e hedhim në votim.

Kush është dakord me propozimin e kolegut Hyseni për ta hequr pikën 4, të nenit 13? 3 pro. Kush është kundër? 5 kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Abstenim? 2 abstenime.

Nuk miratohet propozimi i kolegut Hyseni.

Kush është dakord me variantin e nenit 13 të paraqitur në tekstin integral?

Pro? Kush është kundër? 3 kundër Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po si nuk u miratua?

Varianti yt ra poshtë me votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

A ka mundësi, kolegë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, zoti Qefalia, a ka mundësi?

Hodhëm në votim propozimin e kolegut Hyseni për t'u hequr pika 4 e nenit 13.

Tani hedhim në votim nenin 13, sipas variantit integral, që paraqitet këtu.

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se jemi në votim!

Varianti yt ra.

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Kush është pro?

Zoti Çyrbja, shprehu me votë!

Janë pro deputetët: Fino, Qefalia, Çyrbja, Felaj, Shameti, Manja dhe zonja Xhina.

Miratohet neni 13, sipas variantit integral. Nëse ka amendament për seancë, ju lutem ta formuloni dhe pastaj e zgjidh seanca.

Vazhdojmë me nenin 14, “Mënyra e shpërblimit të avokatit”.

Adnor Shameti - Në lidhje me nenin 14. “Mënyra e shpërblimit të avokatit”. Drafti i paraqitur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Pa problem.

Vazhdoni diskutimin për nenin 14.

Adnor Shameti - Varianti i paraqitur është dakordësuar me misionin EURALIUS, Dhomën Kombëtare të Avokatëve, si dhe me Ministrinë e Drejtësisë.

Ulsi Manja – Ju lutem kolegë, duhet të jemi racionalë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U rrëzua propozimi më i largët. Atëherë, keni detyrim ligjor për t’u shprehur për nenin 13. Kur rrëzohet propozimi si varianti më i largët, duhet të shpreheni për nenin 13 në bazë të Rregullores së Kuvendit .

Ne jemi kolegë këtu dhe jemi me parimin. Unë jo më kot e kam pyetur 3 herë përfaqësuesin e Dhomës, misionin EURALIUS, dhe përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë, se si është standardi evropian në lidhje me këtë nen, sepse legjislacioni ynë do të certifikohet nga misioni EURALIUS dhe nga OPDAT-i. Ky është standardi dhe për këtë jam unë këtu.

Atëherë, kush është dakord me nenin 14, “Mënyra e shpërblimit të avokatit”?

Kemi dakordësi për nenin 14, por meqenëse ne nuk do ta mbyllim sot këtë projektligj, sepse ka shumë nene për të kaluar dhe meqë ligji për provimin e shtetit është në diskutim e sipër, unë ju propozoj ta mbyllim këtu mbledhjen.

Urdhëroni!

Tedi Dobi - Para se ta mbyllni, ka dy propozime për nenin 14, nëse është e mundur.

Ulsi Manja – Jo, nenin 14 e kemi lënë të hapur për radhën tjetër.

Këtu e mbyllim mbledhjen e sotme.

Mbledhja e radhës do të njoftohet nga sekretaria e komisionit nëpërmjet postës elektronike.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

